



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 477/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “B93II” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65452-07-14-2020, me objekt: Loti VII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Vlore (k/spital) - Peshkepi + rruga Peshkepi - Selenicë + rruga Peshkepi - Vllahinë + rruga Vllahinë - Poçem - Povel + rruga Levan - Vlorë (e vjetra) (76,7 km)”, me fond limit 169.211.472 (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B93II” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k. Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ismail Qemali”, Pallati Nr.3/162, Kati 4, Ap.10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65452-07-14-2020, me objekt: Loti VII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Vlore (k/spital) - Peshkepi + rruga Peshkepi - Selenicë + rruga Peshkepi - Vllahinë + rruga Vllahinë - Poçëm - Povel + rruga Levan - Vlorë (e vjetra) (76,7 km)”, me fond limit 169.211.472 (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 05.08.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) për procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 31.08.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave (short-listing) të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|--------------|
| 1. BOE "Meteo" sh.p.k. & "Shendelli" sh.p.k. | kualifikuar |
| 2. BOE "Balili Konstruksion" sh.p.k. & "Agbes" sh.p.k. | kualifikuar |
| 3. "6D - Plan" sh.p.k. | skualifikuar |
| 4. BOE "B93 II" sh.p.k. & "B-93" sh.p.k. | skualifikuar |
| 5. "Bean" sh.p.k. | skualifikuar |
| 6. BOE "Colombo" sh.p.k. & "Don Jurge" sh.p.k. & "Ndërtimi" sh.p.k. | skualifikuar |
| 7. BOE G.A.C" sh.p.k. & "Grand Konstruksion M" sh.p.k. & "Everest" sh.p.k. | skualifikuar |

II.4. Në datën 31.08.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë "B93II" sh.p.k. & "B-93" sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

BOE B 93 shpk & B93 II shpk nuk plotesojne kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, si me poshte vijon:

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur nuk ka permbushur "kriteret e pergjithshme te pranimi/kualifikimit" dhe piken 2.3.2. te kriterave te vecanta per koalifikim ...Si dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se ka mesatarisht të siguruar, jo më pak se 43 punonjës për periudhën Janar 2020–Qershor 2020. Kjo e vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG te konfirmuara [...], Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore nr. T02674935 rezulton me detyrime, nderkohe qe referuar "kriteret e pergjithshme te pranimi/kualifikimit", Ofertuesi ka deklaruar se: d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Ne piken 2.3.8 te kriterave te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... 2.3.8 Operoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme. [...]

Per te plotesuar kete kriter nga BOE B 93 shpk & B93 II shpk, jane dorezuar licensat perkatese te shoqerive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezulton qe:

1. Operatori B 93 shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise:
- Vladimir Marku, drejtues teknik si Inxhinier gjeolog, i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane shoqerise ALBPETROL SHA, ne pozicionin e Drejtorit te Drejtorise.

- Florjan Hoxhaj, drejtues teknik si Inxhinier mjedisi – trajtim ujërash, cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Agjencia se Menaxhimit të Burimeve Ujore, si Specialist përshëndetin mjedisor.

2. Operatori B 93 II shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise:

- Drini Syjanej, drejtues teknik si Inxhinier hidrolog, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH) si Përgjegjës sektori.

- Behar Keko, drejtues teknik si Inxhinier mekanik, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit, si Teknik i stacionit të pompimit.

Në kreun III "Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet", pika 2 dhe pika 3 gërma "a", paragrafi 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "parashikohet se: 2. Elementet e licencës: a) Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV.Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë; VI. Selinë; VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII.Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX.Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje). "[...] Në kreun I "Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime" pika 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "parashikohet se:

"Drejtues teknik"- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Kreu III, pika 3/c, ku thuhet c) Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë.

Si rregull përgjegjësitë e drejtuesit teknik të shoqërisë për këtë periudhë (nga kontraktimi deri në shqyrtimin e kërkesës) mbulohen nga drejtuesi i ri i kontraktuar deri në vendimmarrjen e komisionit. Kur komisioni vendos mospranim të kërkesës ose në mungesë të dokumentacionit të plotë sekretariati teknik dërgon njoftim për plotësim dokumentacioni, sipas paragrafit VI, shkronja "a", pika 4 e kreut II të kësaj rregulloreje, shoqëria detyrohet të pezullojë punimet menjëherë deri në licencimin sipas rregullave dhe procedurave të caktuara në këtë rregullore. [...]

Kreu IV, "Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë" pika 2, percakton: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit. [...]

Ne vijim kreu VII percakton se 1/a “ Heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim, për periudha të ndryshme të shoqërive apo kategori të drejtuesve teknikë të shoqërive, në rastet kur: I. Konstatohen ose provohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme, dokumente të pavërteta të subjektit deklarues. Në këtë rast komisioni heq licencën për një periudhë 5 vjet. II. Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.

Licencat e paraqitur nga te dy operatorët si bashkim i perkohshëm megjithëse janë lëshuar nga institucioni përgjegjës shfaqin të meta dhe nuk përmbushin detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit, VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, për shkak të punësimit të drejtuesve teknike në punëmarrje publike ose shoqëri të tjera ndërtimi.

Referuar pikës 5 gërmës (a) dhe (b) të Kreut II të VKM nr 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, është detyrim ligjor i çdo subjekt të licencuar në zbatim që të aplikojë për përditësimin e të dhënave.

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi, rezulton që nuk ka paraqitur:

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk ka përmbushur piken 2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim të lëshuar nga cdo njësi vendore për të deshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019. Nga ky operator nuk është paraqitur deklarata e kërkuar dhe po kështu nuk është paraqitur vertetim për përmbushjen e detyrimeve vendore për vitin 2019 në Bashkinë Memaliaj, Vlorë dhe Selenicë në të cilat ka pasur aktivitet si pjesë e mirembajtjes së rrugëve në këto njësi administrative.

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk ka përmbushur piken 2.3.10 të kriterëve të vecanta për kualifikim është kërkuar; për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit:- certifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku të jete e dukshme edhe targa e mjetit; ; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratave.; në lidhje me kapacitetin teknik “Kamionçinë deri në 3.5tonë” për mjetet me targa BR 0898 B dhe AA 254 HI, janë perkatesiht BR 0898 B deri në 6.6 ton dhe AA 254 HI deri në 5.6 ton, pra mbi 3.5 ton, në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk ka përmbushur piken 2.3.10 të kriterëve të vecanta për kualifikim është kërkuar; për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit:- certifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; leja e transportit që lëshohet nga

njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.; ne lidhje me kapacitetin teknik “Ekskavator me goma” sepse ky mjet i mare me qera nga subjekti Cobial shpk, rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq – Delvine, ne kundërshtim me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit.

Ne lidhje me kapacitetin teknik “Ekskavator me goma” dhe me qera nga subjekti Cobial shpk, ky rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq – Delvine, ne kundërshtim me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi, rezulton qe nuk ka paraqitur: Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019. Nga ky operator nuk eshte paraqitur nuk eshte paraqitur vertetim per permbushjen e detyrimeve vendore per vitin 2019 ne Bashkine Vlore dhe Selenice ne te cilat ka pasur aktivitet si pjese e mirembjates se rrugeve, ne keto njesi administrative.

Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ne lidhje me kapacitetin teknik “Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 tonë” per mjetet me targa AA674LM, nuk është paraqitur certifikata e kontrollit teknik, ne kundërshtim me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit.Mjeti Batipal I blere me fature tatimore nuk ka paraqitur dokumentacionin që vertetojne pronesine e mjetit. Për mjetin Autobot uji është sipas fotos dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur është kamion me targa TRAA012YB, pra mjeti nuk është në funksion të shërbimit të kërkuar sipas DST.

II.5. Në datën 04.09.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “B93II” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, duke argumentuar si më poshtë vijon:

Vleresimi i bere nga KVO eshte:

- I pabazuar ne aktet ligjore dhe nenligjore per prokurimin publik;**
- Ne kundërshtim te hapur me kriteret e vecanta te kualifikimit te percaktuara sipas Dokumentave te Tenderit nga vet Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.**

Duke qene se nuk biem dakord me vleresimin e bere nga KVO, si subjekt qe ka interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet nga nje vendim i autoritetit kontraktor, i marre ne kundërshtim me kete ligj, ne baze te nenit 63 "Te drejtat e personit te

interesuar", te ligjit 9643/2006 "Per prokurimin publik" me ndryshime, Paraqesim ankesen tone per rivleresim te procedures se siperpermendur.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, ka bere vleresimin e procedures se prokurimit me objekt "Mirembajtje rurine me performance rruga Vlore (k/spital) - Peshkepi + rruga Peshkepi - Selenice+ rruga Peshkepi - Vllahine + rruga Vllahine - Pocern - Povel + rruga Levan - Vlore (e vjetra)": sipas renditjes se meposhtme

Operatoret Ekonomike	vlerat te ofertuara	Refuzuar
"METEO".SH.p.k		JO
BALILI KONSTRUKSION		JO
6D-PLAN		PO
B93 II		PO
BEAN		PO
COLOMBO		PO
G.A.C		PO

Dhe skualifikimin e ofertes sone mbi pretendimet si me poshte listuara:

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur nuk ka permbushur "kriteret e pergjithshme te pranimi/kualifikimit" dhe piken 2.3.2. te kriterëve te vecanta per koalifikim ...Si dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se ka mesatarisht të siguruar, jo më pak se 43 punonjës për periudhën Janar 2020–Qershor 2020. Kjo e vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG te konfirmuara [...], Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore nr. T02674935 rezulton me detyrime, nderkohe qe referuar "kriteret e pergjithshme të pranimi/kualifikimit", Ofertuesi ka deklaruar se: d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi,

Ju sqarojme se BOE "B93 II" shpk"B-93" shpk ka plotesuar kete kriter, pasi vertetimi i paraqitur nga "B-93"me nr nr. T02674935 eshte gjeneruar nga sistemi "e-albania", dhe diferenca qe del e papaguar ne vertetim eshte paguar me date 04.08.2020, por sistemi e azhironon me nje ose dy dite vonese. Per me teper kemi paraqitur edhe nje deklarate "Per pagesen e detyrimeve per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore". Bashkalidhur po ju ri-paraqesim mandatin e pageses per shlyerjen e pageses.

2. Ne piken 2.3.8 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... 2.3.8 Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorie e meposhtme. [...]

Per te plotesuar kete kriter nga BOE B 93 shpk & amp; B93 II shpk, jane dorezuar licensat perkatese te shoqerive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezulton qe:

1.Operatori B 93 shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise: Vladimir Marku, drejtues teknik si Inxhinier gjeolog, i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane shoqerise ALBPETROL SHA, ne pozicionin e Drejtorit te Drejtorise.

- Florjan Hoxhaj, drejtues teknik si Inxhinier mjedisi - trajtim ujerash, cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Agjencia se Menaxhimit te Burimeve Ujore, si Specialist pershendetin mjedisor.

2. Operatori B 93 II shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise:

- Drini Syjanej, drejtues teknik si Inxhinier hidrolog, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH) si Pergjegjes sektori.

- Behar Keko, drejtues teknik si Inxhinier mekanik, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit, si Teknik i stacionit te pompimit.

Ju kujtojme se ne nenin 46, pika 1, te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe perrnasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktojte dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per perrnbushjen e ketyre kriterëve."

Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si me poshte: Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: a) licenca profesionale te shoqerise per realizimin e punimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe/ose b) deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshern per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose c) deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per tc permbushur kontrate"

• Theksojme se licencat e BO te paraqitura ne kete procedure jane ne perputhje me DST dhe me formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi".

• Keto licenca jane te leshuara nga institucionet perkatese shteterore.

• Jane ne perputhje me piken 2.3.8 te kerkuar ne DST.

• Drejtuesit teknik jane me kontrata te rregullta pune, jane ne listpagesat e shoqerise me kohe te plote pune

• Drejtuesit Teknike jane te pajisur me kualifikimet perkatese sic jane diplomat, CV etj sic kerkohet ne DST

• Nga bashkimi i OE jane plotesuar deklaratat perkatese te kerkuara ne DST sipas Pikes 2.3.5

Ju sqarojme ne DST jane kerkuar:

2.3.4 Operatori Ekonomik per kryerjen e te gjitha punimeve/sherbimeve ne objekt, duhet te paraqese nje liste te personelit kryesor, me minimalish:

1 (nje) inxhinier Ndertimi,

1 (nje) inxhinier Mekanik, dhe 1 (nje) inxhinier Gjeolog I 1 (nje) inxhinier Gjeoteknik,

per secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome dhe CV perkatese.

Sa i perket Inxhinierit Mekanik kemi paraqitur dokumentacion per inxhinierin mekanik Panajot Burda, i cili eshte i punesuar me kohe te plote prane subjektit B-93 shpk dhe ne keto kushte kriteri i kerkuar ne DST plotesohet.

Sa i perket Inxhinierit Ndertimi kemi paraqitur dokumentacion per inxhinierin e ndertimit Leonora Mici, i cili eshte i punesuar me kohe te plote prane subjektit B-93 shpk dhe ne keto kushte kriteri i kerkuar ne DST plotesohet.

Sa i perket Kriterit 1 (nje) inxhinier Gjeolog I 1 (nje) inxhinier Gjeoteknik, kemi paraqitur inxhinier Gjeolog Albert Dupi i punesuar me kohe te plote prane subjektit 89311 shpk dhe ne keto kushte kriteri i kerkuar ne DST plotesohet.

Nderkohe qe ju si autoritet ngrini pretendime skualifikimi per "inxhnier mjedisi" ne kundershtrim me DST pasi nuk kerkohet inxhinier i tille, dhe si rrjedhoje kjo arsye skualifikimi nuk qendron.

Gjithashtu, edhe per inxhinier Hidroteknik, qe nuk eshte kerkuar ne DST, eshte ing. Dashnor LICAJ, drejtues teknik i 'B-93' shpk.

Analiza dhe interpretimi i KVO-se nuk qendron pasi BO i ploteson me se miri kriteret e DST, PIKA 2.3. & 2.3.4 & 2.3.5 e kriterëve te vecanta per kualifikim.

Ne zbatim te nenit 46, pika 1, te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", KVO duhet te merret me krahasimin e kriterëve te DST me dokumentacionin e paraqitur nga OE. Por KVO i ka tejkaluar keto te drejta ne menyre selektive duke analizuar vetem drejtuesit teknike te OE "B9311" dhe "B-93".

Theksojme se KVO eshte "kujdesur" ne forem shantazhi per penalizim te bashkimit te operatoreve te sipercituar, por nderkohe i kujtojme KVO-se se duhet te ndjeke nje standart vleresimi per te gjitjhe operatorët e tjere pjesemarres ne procedure prokurimi ose te ndonje operatori te deklaruar si nen kontraktor.

Nga disa investigime dhe te dhena qe publikohen nga institucione shteterore dhe gjithashtu nga te dhena nga burime te ndryshme kemi dyshime te arsyeshme se operatore te tjere pjesemarres ne kete procedure te cilet jane te kualifikuar nga ana e KVO kane keto probleme:

Shoqeria: BALILI KONTRUKSION

Shoqëria Agbes Construction

Shoqëria Meteo sh.p.k.

Shoqëria Shendelli sh.p.k.

LISTA E TE PUNESUARVE ME SHUME SE NJE KOMPANI [...]

[...]

Nisur nga keto te dhena, duket qarte selektiviteti dhe standarti i dyfishte qe perdor KVO ne kete vleresim ndaj operatoreve pjesemarres.

Kjo na ben te mendojme dhe dyshojme se KVO me dashje apo pa-dashje shkel barazine ne tendera, favorizon operatore te paracaktuar duke lene shteg per te ngritur akuza ne baze te "Neni 248 i kodit penal te RSH, Shperdorimi i detyres", Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve ne kundershtrim me ligjin, qe perben rnospermbushje te rregullt te detyres, nga personi qe ushtron funksione publike, kur i kane sjelle atij ose pcrsonave te tjere perfitime materiale ose jomateriale te padrejta a kane demtuar interesat e ligjshern te shtetit, te shtetasve dhe te personave te tjere juridike, nese nuk perben veper tjeter penale, denohet me burgim deri ne shtaie vjet.

Nisur nga sa thame me siper na lind e drejta se KVO edhe per kerkesat e tjera te DST-ve sic jane punimet e ngjashme, makineri-pajisje apo edhe kerkesa te tjera ka bere vleresim selektiv.

Ju kujtojme se ne respekt te nenit 1 pika 2 te LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qellimi i ketij ligji eshte:

- a) te rrisë eficienten dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirepërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonornike në procedurat e prokurimit publik;
- c) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomike;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomike, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në interpretimet e Komisionit të Prokurimit Publik kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, rnakinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonornike pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zoterojnë kapacitetin teknik e konkretisht Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve.

3. Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi, rezulton që nuk ka paraqitur:

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk ka përmbushur pikën 2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim të leshuar nga cdo njësi vendore për të deshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019. Nga ky operator nuk është paraqitur deklarata e kërkuar dhe po kështu nuk është paraqitur vërtetim për përmbushjen e detyrimeve vendore për vitin 2019 në Bashkinë Memaliaj, Vlorë dhe Selenicë në të cilat ka pasur aktivitet si pjesë e mirëmbajtjes së rrugëve në këto njësi administrative.

Deklarojmë se ky kriter konsiderohet i plotësuar nga ana jonë pasi shoqëria "B-93" shpk nuk ka pasur fare aktivitet në Bashkinë Memaliaj, Vlorë dhe Selenicë. Sidoqoftë në këto bashki nuk rezulton të kemi detyrime. Në lidhje me "Nga ky operator nuk është paraqitur deklarata e kërkuar" sqarojmë se është paraqitur kjo deklaratë dhe mund ta gjeni në file-n me emërtimin "B93 Shtojca dhe deklarata" të cilën do t'ju nisim bashkelidhur.

4. Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk ka përmbushur pikën 2.3.10 të kriterëve të vecanta për kualifikim është kërkuar; për mjetet që shënohen në regjistrat publike, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronesinë e mjetit:

- certifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; leja e transportit që leshohet nga njësia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerash e cila duhet të përfaqësojë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës I kontratave.; në lidhje me kapacitetin teknik "Kamioncine deri në 3.5 tone" për mjetet me targa BR 0898 B dhe AA 254 HI, janë perkatesisht BR 0898 B deri në 6.6 ton dhe AA 254 HI deri në 5.6 ton, pra mbi 3.5 ton, në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit, në pikën 2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë deshmi për

mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte:

11. Kamioncine deri ne 3.5 tone ne pronesi ose me qira Cope 3

Per permbushjen e ketij kriteri B.O.E ka paraqitur ne kete procedure:

1- Kamioncine AA 653 TB, sipas lejes se qarkullimit rezulton se Masa maksimale e Autorizuar eshte 3000 kg, pesha e vete mjetit 1849 kg dhe kapaciteti mbajtes eshte 1151 kg, pra me e vogel se 3.5 ton qe eshte kerkuar ne DST.

2- Kamioncine BR 0898 B, sipas lejes se qarkullimit rezulton se Masa maksimale e Autorizuar eshte 6600 kg, pesha e vete mjetit 3520 kg dhe kapaciteti mbajtes eshte 3080 kg, pra me e vogel se 3.5 ton qe eshte kerkuar ne DST.

3- Kamioncine AA 254 HI, sipas lejes se qarkullimit rezulton se Masa maksimale e Autorizuar eshte 5600 kg, pesha e vete mjetit 3780 kg dhe kapaciteti mbajtes eshte 1820 kg, pra me e vogel se 3.5 ton qe eshte kerkuar ne DST.

Sipas llogaritjeve aritmetike, te tre treja kamioncinat e paraqitura jane me kapacitet mbajtes nen 3.5 ton. Autoriteti Kontraktor ne kriteret e percaktuara per kualifikim nuk ka specifikuar nese 3.5 ton i referohet Mases maksimale te Autorizuar apo Kapacitetit mbajtes.

B.O.E e ka permbushur kriterin e kerkuar per paraqitjen e tre kamioncinave deri ne 3.5 ton. Arsyeja e skualifikimit nuk qendron.

5. Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit: • certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, kn te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates/kontratave.; ne lidhje me kapacitetin teknik "Ekskavator me goma" sepse ky mjet i mare me qera nga subjekti Cobial shpk, rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq - Delvine, ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Ne lidhje me kapacitetin teknik "Ekskavator me goma" dhe me qera nga subjekti Cobial shpk, ky rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq - Delvine, ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte:

16. Ekskavator me goma ne pronesi ose me qira Cope 1

Per permbushjen e ketij kriteri B.O.E ka paraqitur ne kete procedure:

1-Eskavator me goma LIEBHERR, A924 me kontrate qera noteriale, e vlefshme per te gjithë periudhen e ekzekutimit te kontrates, shoqeruar me te gjithë dokumentacionin teknik te nevojshem e te kerkuar.

2- Eskavator me goma AEMT 71 me kontrate qera noteriale, e vlefshme per te gjithë periudhen e ekzekutimit te kontrates, shoqeruar me shoqeruar me te gjithë dokumentacionin teknik te nevojshem e te kerkuar.

Kontratat noteriale te paraqitura kane fuqi ligjore.

6. Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi, rezulton qe nuk ka paraqitur: Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019. Nga ky operator nuk eshte paraqitur nuk eshte paraqitur vertetim per permbushjen e detyrimeve vendore per vitin 2019 ne Bashkine Vlore dhe Selenice ne te cilat ka pasur aktivitet si pjese e mirembjates se rrugeve, ne keto njesi adrnministrative.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.2.3 eshte kerkuar "Operatori Ekonomik duhet te paraqese nji: deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Operatori ekonomik B93 II shpk, pjese e ketij bashkimi, ne permbushje te kriterit te mesiperm ka paraqitur ne kete procedure:

- 1. Deklarate se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2019*
- 2. Vertetim nga Bashkia Fier se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2019*
- 3. Vertetim nga Bashkia Selenice se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2019*

Operatori ekonomik B93 II shpk, nuk ka ushtruar aktivitet ne Bashkine Vlore pergjate vitit 2019. Kjo arsye skualifikimi nuk qendron.

7. Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit: • certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit;; ne lidhje me kapacitetin teknik "Mjet transporti veteshkarkues mbi 8 tone" per mjetet me targa AA674LM, nuk eshte paraqitur certifikata e kontrollit teknik, ne kundërshtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Arsyeja e ngritur nga Komisioni i Vleresimit te ofertave, se per mjetin me targa AA674LM, nuk eshte paraqitur certifikata e kontrollit teknik, nuk qendron.

Nese do te kontrollohen me vemendje e pergjegjshmeri, dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, do te vihej re se Mjeti me AA674 LM eshte paraqitur i shoqeruar nga kontrata e shitblerje fq 1 dhe 2, certifikata e pronesise fq3 dhe 4, leja e qarkullimit fq 5 dhe 6, certifikata e kontrollit teknik fq7, siguracioni fq8, mandati i taksave fq9, certifikata e transportit fq 10 dhe foto fq 11.

Arsyeja e skualifikimit nuk qendron.

8. Mjeti Batipal i blere me fature tatimore nuk ka paraqitur dokumentacionin qe vertetojne pronesine e mjetit.

Shoqerite tregtare ne aktivitetin e tyre te perditshem, operojne nepermjet faturave tatimore, te cilat ne vetvete tregojne per shitblerjen e mallave, sherbimeve, pajisjeve nepermjet njera-tjetres. Theksojme qe kjo pajisje eshte blere brenda vendit dhe per kete arsye shoqerohet me fature tatimore.

9. Per mjetin Autobot uji eshte sipas fotos dhe dokumentacionit shoqerues te paraqitur eshte kamion me targa AA012YB, pra mjeti nuk eshte ne funksion te sherbimit te kerkuar sipas DST.

- BOE B 93 shpk & B93 II shpk nuk plotesojne kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, si me poshte vijon:

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per Dokumenta Standarde te Tenderit mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte:

7.Autobot uji ne pronesi ose me qira Cope 1

Per permbushjen e ketij kriteri B.O.E ka paraqitur ne kete procedure:

Autobot uji AA012 YB, me kontrate qera noteriale, e vlefshme per te gjithë periudhen e ekzekutimit te kontrates shoqeruar me certifikate pronesie, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni, mandati i taksave, certifikata e transportit dhe foto.

Nese Komisioni i Vleresimit te Ofertave, do te tregohej perseri i vemendshem do te vinte re se ne certifikaten e pronesise se mjetit dhe ne lejen e qarkullimit te tij, ne kategorine Lloji i Mjetit eshte e percaktuar ATV dhe jo Kamion.

Dokumentacioni teknik duhet te shqyrtohen me pergjegjshmeri dhe objektivitet, duke lexuar te gjitha te dhenat e disponueshme ne to, asesi nuk mund te behet duke pare vetem fotografine.

SI PERFUNDIM, per sa me siper kerkojme kualifikimin tone, duke qene se plotesojme te gjitha kriteret e vendosura per Kualifimin.

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP, nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.6448/2 prot, datë 11.09.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit i operatorëve ekonomikë “B93II” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k., duke e refuzuar atë. Ndërkohë që, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes në datë 17.09.2020. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka argumentuar:

[...]

III. I. Lidhur me pretendimin e BOE B93 & B93 II sh.p.k, mbi skualifikimin e tij me arsyen: "[...] Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur "kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit" dhe piken 2.3.2. te kriterave te vecanta per kualifikim ... Si deshmi per fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, kandidati/ofertuesi duhet te vertetoje se ka mesatarisht te siguruar, Jo me pak se 43 punonjes per periudhen Janar 2020-Qershor 2020. Kjo e vertetuar me: Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e kerkuar, shoqeruar me formularet E-SIG le konfirmuara [...], Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore nr. T02674935 rezulton me detyrime, nderkohe qe referuar "kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit ", Ofertuesi ka deklaruar se: d) ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e tatimeve e te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas legjislacionit ne fuqi [...]

Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses veren se:

III. 1.1 Ne shtojcen 10, "Kriteret e vecanta te kualifikimit", ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kerkuar si vijon:

KRITERET E PERGJITHSHME TEP PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet te deklaroje se:

d) ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e tatimeve e le kontributeve le sigurimeve shoqerore, sipas legjislacionit ne fuqi. [...]

III.1.2 Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : "[...] Operatoret ekonornike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene perrnbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshrne, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese [...]".

III.1.3 Ne nemn 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji."

III.1.4 Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.Sh.A. konstaton se per te plotesuar kriterin e vendosur ne DST, anetari i BOE B93 ka paraqitur Vertetimin nr. T02674935 e leshuar nga Administrata Tatimore i cili rezulton me detyrime ne zerin "Gjoba lidhur me kontributet: 309 leke". Udhezimit te Ministrit te Financave Nr. 23 date 9.12.2014 "Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore" pika 4 "Detyrimi per deklarimin dhe pagesat e kontributeve" percaktohet se: "Tatimpaguesit persona juridike dhe fizike jane te detyruar te deklarojne ne organet tatimore vetem ne forme elektronike te dhenat per kontributetet ne total dhe per cdo individ brenda afateve te caktuara. Afatet e deklarimit dhe te pageses se detyrimeve per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore percaktohen bazuar ne statusin e regjistrimit te tatimpaguesve. a) Deklarojne dhe paguajne cdo muaj brenda dates 20 te muajit pasardhes Ne mbeshtetje te Udhezimit te Ministrit te Financave OE "B-93" shpk per muajin Qershor 2020 i kerkuar nga AK ne DST ka patur afat ligjor per likujdim te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore deri ne daten 20 Korrik 2020, afat te cilin nuk e ka respektuar e pasqyruar edhe ne Urdher Pagese -1900, Kontributet e sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore, te dative 29.07.2020, 03.08.2020 dhe 04.08.2020 ku pervec vleres se principalit per Kontributet e sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore figurojne edhe detyrime per gjoba dhe interesa.

Jane pikerisht keto gjoba e interesa te gjeneruara per periudhen ndermjet pageses se fundit e dates se terheqjes se vertetimit, qe pasqyrohen ne vertetimin e leshuar nga Administrata Tatimore Nr. T02674935 Date, 05.08.2020 si rezultat i mosrespektimit te Udhezimit te Ministrit te Financave Nr. 23 date 9.12.2014 dhe jo mos azhornimi i systemin tatimor deli me daten 05.08.2020, sikurse deklarone ne menyre OE "B-93" shpk.

Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qendron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE B93 & B93 II sh.p.k, mbi skualifikimin e tij me arsyen: "[...] Ne piken 2.3.8 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... 2.3.8 Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e

dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne

veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme. [...]

Per te plotesuar kete kriter nga BOE B 93 shpk & B93 II shpk, jane dorezuar licencat perkatese te shoqerive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezulton qe: 1. Operatori B 93 shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise: - Vladimir Marku, drejtues teknik si Inxhinier gjeolog, i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane shoqerise ALBPETROL SHA, ne pozicionin e Drejtorit te Drejtorise. - Florjan Hoxhaj, drejtues teknik si Inxhinier mjedisi – trajtim ujërash, cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Agjencia se Menaxhimit të Burimeve Ujore, si Specialist përshëndetin mjedisor.

2. Operatori B 93 II shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise: - Drini Syjanej, drejtues teknik si Inxhinier hidrolog, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH) si Përgjegjës sektori.

- Behar Keko, drejtues teknik si Inxhinier mekanik, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit, si Teknik i stacionit të pompimit.

Në kreun III "Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet", pika 2 dhe pika 3 gërma "a", paragrafi 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "parashikohet se: 2. Elementet e licencës: a) Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV.Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë; VI. Selinë; VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII.Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX.Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje). "[...] Në kreun I "Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime" pika 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "parashikohet se: "Drejtues teknik"- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Kreu III, pika 3/c, ku thuhet c) Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë. Si rregull përgjegjësitë e drejtuesit teknik të shoqërisë për këtë periudhë (nga kontraktimi deri në shqyrtimin e kërkesës) mbulohen nga drejtuesi i ri i kontraktuar deri në vendimmarrjen e komisionit. Kur komisioni vendos mospranim të kërkesës ose në mungesë të dokumentacionit të plotë sekretariati teknik dërgon njoftim për plotësim dokumentacioni, sipas paragrafit VI, shkronja "a", pika 4 e kreut II të kësaj rregulloreje, shoqëria detyrohet të pezullojë punimet menjëherë deri në licencimin sipas rregullave dhe procedurave të caktuara në këtë rregullore. [...] Kreu IV, "Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë" pika 2, percakton: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë

njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit. [...] Ne vijim kreu VII percakton se 1/a “ Heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim, për periudha të ndryshme të shoqërive apo kategori të drejtuesve teknikë të shoqërive, në rastet kur: I. Konstatohen ose provohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme, dokumente të pavërteta të subjektit deklarues. Në këtë rast komisioni heq licencën për një periudhë 5 vjet. II. Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet. Licencat e paraqitur nga te dy operatorët si bashkim i perkohshem megjithëse janë lëshuar nga institucioni përgjegjës shfaqin të meta dhe nuk përmbushin detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit, VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, për shkak të punësimit të drejtuesve teknike në punëmarrje publike ose shoqëri të tjera ndërtimi. Referuar pikës 5 gërmës (a) dhe (b) të Kreut II të VKM nr 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, është detyrim ligjor i çdo subjekt të licencuar në zbatim që të aplikojë për përditësimin e të dhënave. [...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës venen se:

III.2.1 Në shtojcën 10, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

[...]

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi ". Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara më sipër. [...]

III.2.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.Sh.A. konstaton se për të deshmuar plotësimin e kriterit sipas pikës 2.3.8 të dst, anëtarët e BOE kanë paraqitur licensat me nr NZ. 0747/23 dhe NZ. 7274/6. Referuar legjislacionit në fuqi, drejtuesit teknikë duhet të jenë të punësuar me kohë të plote pranë subjektit të licensuar. Nga ana e subjektit ankimes nuk kundërshtohet fakti që drejtuesit teknikë të siperpërndur ushtrojnë funksione të tjera , madje të larta, në institucione publike. KVO ka skualifikuar BOE B-93 shpk & B93 II shpk për pavlefshmëri të licensave të kërkuar në pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST dhe jo për mosplotësim të kapaciteteve teknike të kërkuar në pikën 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST. Licensat profesionale rezultojnë të parregullta pasi janë në kundërshtim me VKM nr 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", Kreu IV, "Drejtuesi teknik i shoqërise dhe papajtueshmëria me këtë detyrë" pika 2, percakton: Drejtuesit teknikë të shoqërise nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërise

nuk mund të jete njekohesisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikeqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit. [...] Në vijim kreu VII përcakton se l/a" Heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e perkohshëm në zbatim, për periudha të ndryshme të shoqërive apo kategori të drejtuesve teknike të shoqërive, në rastet kur: I. Konstatohen ose provohen deklaratime (sipas parashikimeve në këto rregullore) të rreme, dokumente të pavërteta të subjektit deklarues. Në këto rast komisioni heq licencën për një periudhë 5 vjet. II. Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këto rregullore. Në këto rast komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesin për një periudhë 3 vjet. Licencat e paraqitur nga të dy operatorët si bashkim i perkohshëm megjithatë janë leshuar nga institucioni përgjegjës shfaqin të meta dhe nuk përmbushin detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit, VKM Nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", për shkak të punësimit të drejtuesve teknike në punëmarrje publike ose shoqëri të tjera ndërtimi. Referuar pikës 5 gërmes (a) dhe (b) të Kreut II të VKM nr 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", është detyrim ligjor i çdo subjekti të licencuar në zbatim që të aplikojë për përditesimin e të dhënave.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e anetareve të BOE B93 & B93 II sh.p.k, mbi skualifikimin e tyre me arsyen: "[...] Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk ka përmbushur pikën 2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim të leshuar nga çdo njësi vendore për të deshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019. Nga ky operator nuk është paraqitur deklarata e kerkuar dhe po kështu nuk është paraqitur vertetim për përmbushjen e detyrimeve vendore për vitin 2019 në Bashkinë Memaliaj, Vlorë dhe Selenicë në të cilat ka pasur aktivitet si pjesë e miremëbajtjes së rrugëve në këto njësi administrative. [...]. Nga verifikimi në SPE, anetaret e BOE B93 & B93 II kanë zhvilluar veprimtari gjatë vitit 2019 në Bashkinë Memaliaj, Vlorë dhe Selenicë mirepo nuk kanë paraqitur vertetim për përmbushjen e detyrimeve vendore në këto Bashki. K.Sh.A verën se kjo bie në kundërshtim me nenin 43, pika 3-d, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT" i ndryshuar. Regjistrimet e tjera të detyrueshme të subjekteve janë edhe: d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia. Moskryerja e regjistrimit të vendit të ushtrimit të veprimtarisë ka për qëllim shmangien e detyrimeve tatimore të taksave vendore në Bashkinë Memaliaj, Vlorë dhe Selenicë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e anetarit të BOE 893 & B93 II sh.p.k, mbi skualifikimin e tij me arsyen: "[...] Operatori ekonomik B 93 shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk ka përmbushur pikën 2.3.10 të kriterëve të vecanta për kualifikim është kerkuar; për mjetet që shënohen në regjistrin publik, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; leja e transportit që leshohet nga njësia vendore dhe foto perkatese, me ngjyra, ku të jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jete e vlefshme për të

gjithe periudhen e realizimit te kontrates/kontratave; ne lidhje me kapacitetin teknik "Kamioncine deri ne 3.5 tone" per mjetet me targa BR 0898 B dhe AA 254 HJ, Jane perkatesiht BR 0898 B deri ne 6.6 ton dhe AA 254 HI deri ne 5.6 ton, pra mbi 3.5 ton, ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit [...].

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.Sh.A. konstaton se per te provuar disponueshmerine e mjeteve anetari i BOE B93 shpk ka paraqitur mjetet me targa BR0898 B dhe AA 254 HI, jane perkatesiht BR 0898 B deri ne 6.6 ton dhe AA 254 HI deri ne 5.6 ton, pra mbi 3.5 ton, ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, sikurse pranohet nga vete ankimesi. Ne DST kerkohet specifikisht Kamioncine deri ne 3.5 tone pa e tejkaluar peshen maksimale.

Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qendron.

III.4. Lidhur me pretendimin e anetarit tr BOE B93 & B93 II sh.p.k, mbi skualifikimin e tij me arsyen: "[...] Mjeti Batipal i blere me fature tatimore nuk ka paraqitur dokumentacionin qe vertetojne pronesine e mjetit [...]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.Sh.A. konstaton se per te deshmuar disponueshmerine e Mjet (Batipal) per vendosje parrakesh metalik (guardrails) anetari i BOE B93 shpk ka paraqitur vetem faturen tatimore me date 25.06.2018, te pa shoqeruar me dokumente qe vertetojne origjinen dhe ekzistencen e mjetit, kjo ne kundershtim me DT. Ne lidhje me kapacitetin teknik "Mjet (Batipal) per vendosje parrakesh metalik (guardrails)" eshte parqitur Fature Tatimore Shitje, si shites figuron B93 II shpk dhe si bleres B 93 shpk, pra subjektet qe jane edhe bashkim operatoresh ne kete procedure prokurimi. Referuar QKB ne aktivitetin e B93 II shpk nuk figuron "Prodhim, mjete (batipal) per vendosje parrakesh metalik (guardrails)". Per te mbeshtetur sa me siper per kapacitetin teknik "Makineri per vijezim rrugor" nga ana e BOE B93 & B93 II shpk rezulton se eshte parqitur Fature Tatimore Shitje ku si shites figuron B93 shpk dhe si bleres B 93 II shpk, por ne kete rast pronesia e ketij kapaciteti teknik nga ana e B93 shpk eshte vertetuar nepermjet Deklarates Doganore Nr.R40388. Mjeti i paraqitur me kete fature tatimore eshte nje mjet i prodhuar dhe importuar nga jashte vendit dhe gjithashtu eshte mjet qe nuk shenohet ne regjistra publike, i cili kur eshte ne pronesi, duhet te paraqitet kontrata e blerjes/cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates/kontratave. Pra, ne dst me termin "duhet te" kerkohet detyrimisht dhe qartesisht bashkesia e dokumenteve qe vertetojne origjinen e mjetit me te cilen eshte bere pronar shitesi i tij. Eshte detyrim i operatorit pjesmarres ne tender, sigurimi ne teresi dhe jo pjeserisht, i dokumentacionit justifikues ne perputhje me dst. Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qendron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera te BOE B93 & B93 II sh.p.k per skualifikimin e ofertes se tyre ne proceduren e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses gjykon se per sa kohe qe pretendimet e mesiperrne nuk qendrojne pasi operatori ekonomik ankimes nuk permbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyesimit te K.SHA mbetet e skualifikuar, shqyrtimi ne themel i pretendimeve te tjera te pales ankimese nuk ndryshojne gjendjen juridike te ketij BOE e per rrjedhoje nuk do te merren ne shqyrtim ne respekt te parimit te ekonomise ne shqyrtimin administrativ.

Per sa me siper ne perfundim , ne mbeshtetje te nenit 63 , pika 3, 5 dhe 6, te ligjit 9643 dt. 20/11/2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per

R.regullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu X, " Shqyrtimi i ankesave ", Neni 78 "Ankesat ne autoritetin kontraktor" Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses, njezeri: Vendosi Refuzimin e ankeses duke mos marre parasysh kerkesen e ankirnuesit BOE B93 & B93 II sh.p.k. Kopje e ketij vendimi do ti komunikohet menjehere titullarit te autoritetit kontraktor si dhe do ti komunikohet me shkrim ankimuesit.

Per efekt te shkurtimit te afateve kohore te procesit te ankimit, komisioni per shqyrtimin e ankeses i komunikon vendimin ankimuesit edhe ne adresen elektronike te percaktuar prej tij ne formularin e ankeses, jo me vone se ditën e nesërme te punes pas marrjes se vendimit.

II.7. Në datën 18.09.2020 bashkimiti operatorëve ekonomikë “B93II” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë:

[...]

Fillimisht shoqeria jone ka paraqitur ankese prane autoritetit kontraktor me dt 04.09.2020, duke kerkuar kualifikimin e ofertes se paraqitur prej nesh ne kete procedure prokurimi.

Autoriteti Kontraktor, ne perfundim te shqyrtimit te ankeses nga KSHA, nepermjet shkreses date 11.09.2020 marre dijeni me date 17.09.2020, beri me dije OE ankimues se ankesa e paraqitur prej tij eshte refuzuar. Duke mos e gjetur te drejte vendimin e KSHA per lenien ne fuqi te vendimit te KVO per skualifikimin e ofertes sone, paraqesim kete ankese pane Komisionit te Prokurimit.

1.Lidhur arsyen e skualifikimit;

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur nuk ka permbushur “kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” dhe piken 2.3.2. te kriterëve te vecanta per koalifikim ...Si dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se ka mesatarisht të siguruar, jo më pak se 43 punonjës për periudhën Janar 2020–Qershor 2020. Kjo e vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG te konfirmuara [...], Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore nr. T02674935 rezulton me detyrime, nderkohe qe referuar “kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, Ofertuesi ka deklaruar se: d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese."

Bejme me dije se dhe prane autoritetit kontraktor kemi specifikuar se ne datën e hapjes se ofertave shoqeria jone ka shlyer te gjitha detyrimet tatimore perkatese sic e provuam dhe me dokumentacion shoqerues por ky pretendim nuk u pranuar nga AK.

Sqarojme serish se, OE ankimues ka shlyer te gjitha detyrimet ne datën e zhvillimit te procedurës se prokurimit dhe per kete fakt ka leshuar dhe deklaraten e specifikuar ne Kriteret e Pergjithshme te kualifikimit. Edhe nepermjet dokumentacion te dorezuar se bashku me ankesen ne AK provuam se shuma e pretenduar eshte paguar me datën 04.08.2020 (pra nje dite perpara hapjes se ofertave), por per shkak se sistemi elektronik i tatimeve dhe e-albania i gjeneron ato me vonese nuk eshte pasqyruar ky veprim i kryer prej nesh por referuar kriterëve te kualifikimit Oe ankimues nuk ka detyrimin per te dorezuar ndonje dokument per te provuar shlyerjen e detyrimeve tatimore por ne

vend te tyre eshte vendosur leshimi i deklarates ku OE ankimues ka deklaruar se nuk ka detyrime te pashlyera prane organeve tatimore.

Ne rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave te tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk eshte percaktuar apo vendosur ndonje kerkese specifike ne lidhje me vertetimin e leshuar per numrin e punonjesve por me ate te tij te provohet vetem numri I te punesuarve, pra eshte kerkuar thjesht paraqitja e ketij dokumenti pa ndonje percaktim tjeter te vecante apo specifik, ndaj arsyeja e skualifikimit te dhene nga ana e AK-se nuk qendron, dhe nje kriter i pakerkuar ne dokumentat e tenderit nuk duhet te perbeje shkak per skualifikim. Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kriterëve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor, te cilat per me teper jane paraqitur nga OE ankimues. Per pasoje, operatorët ekonornike pjesemarrës ne nje procedure prokurimi duhet te plotesojne vetem kerkesat e vendosura ne dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vleresimi e kualifikimi i tyre duhet te behet ne perputhje vetem me keto kerkesa.

Gjithashtu, ligji ju njej si autoritetit kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik te drejten per te verifikuar prane organeve te tjera shteterore mbi saktesine, vertetesine e dokumentave apo deklarimeve te dhena nga oe pjesmarres.

Akoma me tej, rezulton se OE ankimues te kete paraqitur nje deklarate ku ka deklaruar se ka shlyer detyrimin e pretenduar dhe autoritetit kontraktor ka te drejten e verifikimit te kesaj deklarate.

2.Lidhur me arsyen per skualifikim;

Ne piken 2.3.8 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... 2.3.8 Operatorët ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorie e meposhtme. [...]

Per te plotesuar kete kriter nga BOE B 93 shpk & amp; B93 II shpk, jane dorezuar licensat perkatese te shoqerive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezulton qe:

1.Operatori B 93 shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise: Vladimir Marku, drejtues teknik si Inxhinier gjeolog, i cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane shoqerise ALBPETROL SHA, ne pozicionin e Drejtorit te Drejtorise.

- Florjan Hoxhaj, drejtues teknik si Inxhinier mjedisi - trajtim ujerash, cili rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Agjencia se Menaxhimit te Burimeve Ujore, si Specialist pershendetin mjedisor.

2. Operatori B 93 II shpk midis te tjereve rezulton te kete si drejtues teknik te shoqerise:

- Drini Syjanej, drejtues teknik si Inxhinier hidrolog, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.a KESH) si Pergjegjes sektori.

- Behar Keko, drejtues teknik si Inxhinier mekanik, rezulton te jete i punesuar me kohe te plote prane Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit, si Teknik i stacionit te pompimit.

Neni 46, pika 1 e LPP, I ndryshuar [...].

Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si me poshte: Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: a) licenca profesionale te

shoqerise per realizimin e punimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe/ose b) deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose c) deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontrate"

- Theksojme se licencat e BO te paraqitura ne kete procedure jane ne perputhje me DST dhe me formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi".

- Keto licenca jane te leshuara nga institucionet perkatese shteterore.

- Jane ne perputhje me piken 2.3.8 te kerkuar ne DST.

- Drejtuesit teknik jane me kontrata te rregullta pune, jane ne listpagesat e shoqerise me kohe te plote pune

- Drejtuesit Teknike jane te pajisur me kualifikimet perkatese sic jane diplomat, CV etj sic kerkohet ne DST

- Nga bashkimi i OE jane plotesuar deklaratat perkatese te kerkuara ne DST sipas Pikes 2.3.5 PRETENDIMI I AK-se eshte abuziv pasi nga ana e OE pjesmarres nuk jane paraqitur dhe as jane deklaruar per tu angazhuar inxhinieret e sipercituar nga AK, e konkretisht sqarojme se:

Sa i perket Inxhinierit Mekanik kemi paraqitur dokumentacion per inxhinierin mekanik Panajot Burda, i cili eshte i punesuar me kohe te plote prane subjektit B-93 shpk dhe ne keto kushte kriteri i kerkuar ne DST plotesohet.

Sa i perket Inxhinierit Ndertimi kemi paraqitur dokumentacion per inxhinierin e ndertimit Leonora Mici, i cili eshte i punesuar me kohe te plote prane subjektit B-93 shpk dhe ne keto kushte kriteri i kerkuar ne DST plotesohet.

Sa i perket Kriterit 1 (nje) inxhinier Gjeolog/ 1 (nje) inxhinier Gjeoteknik, kemi paraqitur inxhinier Gjeolog Albert Dupi i punesuar me kohe te plote prane subjektit B93II shpk dhe ne keto kushte kriteri i kerkuar ne DST plotesohet .

Gjithashtu edhe per inxhinier Hidroteknik, qe nuk eshte kerkuar ne DST, eshte ing. Dashnor Licaj, drejtues teknik i "B-93" shpk.

Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kriterëve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor.

Ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimine kontrates dhe ne dokumentat e tenderit..."

Ne asnje rast autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje apo te vleresoje nje oferte tej atyre te parashikuara ne DST. Kriteret e parashikuara ne DST jane kufiri maksimal i kriterëve te kerkuara nga AK dhe cdo konstatim apo kerkim i AK-se tej atyre te parashikuara ne DST eshte ne kundërshtim me ligjin dhe absolutisht i pavlefshern.

Nder te tjera eshte shkelur dhe parimi i ligjshmerise, i saksionuar si ne K.Pr. Administrative por dhe ne Ligjin "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar pasi ky verifikim eshte kryer vetem per OE ankimues.

Nga disa investigime dhe te dhena qe publikohen nga institucione shteterore dhe gjithashtu nga te dhena nga burime te ndryshme kemi dyshime te arsyeshme se operatore te tjere pjesemarres ne kete procedure te cilet jane te kualifikuar nga ana e KVO kane keto problem dhe:

Shoqeria: BALILI KONTRUKSION

Shoqëria Agbes Construction

Shoqëria Meteo sh.p.k.

Shoqëria Shendelli sh.p.k.

LISTA E TE PUNESUARVE ME SHUME SE NJE KOMPANI [...]

[...]

Nisur nga keto te dhena, duket qarte selektiviteti dhe standarti i dyfishte qe perdor KVO ne kete vleresim ndaj operatoreve pjesemarres. Si rrjedhoje AK me se paku ka vleresuar me standart te dyfishte ku ne rastin se vleresimi do te kryhej per te gjitha subjektet perkatese objektiv duhet te kishin nje skualifikim te te gjithë OE te kualifikuar ose AK me dashje ka vepruar me subjektivizem duke vepruar ne kufijt e "Shperdorimit te Detyres" parashikuar nga neni 248 I K. Penal dhe "Shkelje e barazise se pjesmarresve ne tendera ose ankande publike".

KOMISIONI PROKURIMIT PUBLIK, BAZUAR DHE NE DISPOZIT ATE LIGJORE NE FUQI TE VERIFIKOJE LIGJSHMERINE E VEPRIMEVE TE AK-SE, NGA VERIFIKIMI I PRETENDIMET PER OFERTEN TONE, RRUGEN E NDJEKUR ME ORGANET KOMPETENTE DHE ATO NE RAPORT ME OFERTUESIT E TJERE. OE ANKIMUES REZERVON TE DREJTEN PER TJU DREJTUAR ME KALLEZIM PENAL PROKURORISE SPECIALE KUNDER KRIMIT TE ORGANIZUAR DHE KORUPSION NE RAST TE MOSSHQYRTIMIT TE LIGJSHMERISE SE VEPRIMEVE TE KRYERA NGA AK.

3. Lidhur me arsyen e skualifikimit;

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019. Nga ky operator nuk eshte paraqitur deklarata e kerkuar dhe po keshtu nuk eshte paraqitur vertetim per permbushjen e detyrimeve vendore per vitin 2019 ne Bashkine Memaliaj, Vlore dhe Selenice ne te cilat ka pasur aktivitet si pjese e mirembjates se rrugeve ne keto njesi adrnministrative.

Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kritereve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor.

Ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ...".

Deklarojme se ky kriter konsiderohet i plotesuar nga ana jone pasi shoqeria "B-93" shpk nuk ka pasur fare aktivitet ne Bashkine Memaliaj, Vlore dhe Selenice. Sidoqofte ne keto bashki nuk rezulton te kemi detyrime.

Ne lidhje me "Nga ky operator nuk eshte paraqitur deklarata e kerkuar" sqarojme se eshte paraqitur dhe mund ta gjeni ne file-n me emertimin "B93 Shtojca dhe deklarata". Nje kopje te ketyre dokumentave te cilat jane ngarkuar dhe ne SPE do ti gjeni bashkelidhur kesaj ankese.

Sa i takon interpretimit te KVO-se" keshtu nuk eshte paraqitur vertetim per permbushjen e detyrimeve vendore per vitin 2019 ne Bashkine Memaliaj, Vlore dhe Selenice ne te cilat ka pasur aktivitet si pjese e mirembajtjes se rrugeve ne keto njesi administrative" duam te shprehemi ne mbeshtetje e ne zbatim te legjislacionit tatimor te republikes se Shqiperise se:

Tarifat dhe taksat vendore aplikohen per te gjitha bizneset qe ushtrojne aktivitet ne territorin qe administrohet nga Njesite vendore.

Kontratat e mirembajtjes jane kontrata sherbimi te lidhura me Autoritetin Rrugor Shqiptar me objekt sherbimet e mirembajtjes, punime keto qe ekzekutohen vetem ne siperfaqen e akseve nacionale, te cilat jane nen juridiksionin e Autoritetin Rrugor Shqiptar, jo te Njesive te qeverisjes vendore. Per keto kontrata, Njesite e qeverisjes Vendore nuk kane tages te kerkojne te paguhen Taksat vendore, pasi aktiviteti nuk ushtrohet nen juridiksionin e tyre, sic percaktohet qartesisht ne Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 "Per sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 date 17.12.2015,dhe ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", I ndryshuar.

4.Lidhur me arsyen e skualifikimit;

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates I kontratave; ne lidhje me kapacitetin teknik "Kamioncine deri ne 3.5tone" per mjetet me targa BR 0898 B dhe AA 254 HI, jane perkatesiht BR 0898 B deri ne 6.6 ton dhe AA 254 HI deri ne 5.6 ton, pra mbi 3.5 ton, ne kundërshtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmie per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte:

11. Kamioncine deri ne 3.5tone ne pronesi ose me qira Cope 3

Per permbushjen e ketij kriteri B.O.E ka paraqitur ne kete procedure:

1- Kamioncine AA 653 TB, sipas lejes se qarkullimit rezulton se Masa maksimale e Autorizuar eshte 3000 kg, pesha e vete mjetit 1849 kg dhe kapaciteti mbajtes eshte 1151 kg, pra me e vogel se 3.5 ton qe eshte kerkuar ne DST.

2- Kamioncine BR 0898 B, sipas lejes se qarkullimit rezulton se Masa maksimale e Autorizuar eshte 6600 kg, pesha e vete mjetit 3520 kg dhe kapaciteti mbajtes eshte 3080 kg, pra me e vogel se 3.5 ton qe eshte kerkuar ne DST.

3- Kamioncine AA 254 HI, sipas lejes se qarkullimit rezulton se Masa maksimale e Autorizuar eshte 5600 kg, pesha e vete mjetit 3780 kg dhe kapaciteti mbajtes eshte 1820 kg, pra me e vogel se 3.5 ton qe eshte kerkuar ne DST.

Sipas llogaritjeve aritmetike, te tre treja kamioncinat e paraqitura jane me kapacitet mbajtes nen 3.5 ton.

Autoriteti Kontraktor ne kriteret e percaktuara per kualifikim nuk ka specifikuar nese 3.5 ton i referohet Mases maksimale te Autorizuar apo Kapacitetit mbajtes.

Nga verifikimi i dokumentave te tenderit, rezulton se jane percaktuar kriteret e pergjithshme dhe kriteret e vecanta per kualifikim, nga ku evidentohet te jete percaktuar vetem kriteri qe kamioncina duhet te jene 3 cope deri ne 3,5 tone por pa specifikuar nese i referohen Mases Maksimale te Autorizuar apo Kapacitetit mbajtes.

Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kriterëve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta/kritere shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor, te cilat per me teper jane paraqitur nga OE ankimues. Per pasoje, operatorët ekonornike pjesemarrës ne nje procedure prokurimi duhet te plotesojne vetern kerkesat e vendosura ne dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vleresimi e kualifikimi i tyre duhet te behet ne perputhje vetern me keto kerkesa.

Gjithashtu, nga ana tjeter, OE ankimues ka nenshkruar deklaraten e permbushjes se specifikimeve teknike, ku deklarone plotesimin e te gjitha specifikimeve teknike, duke rnarre persiper nen pergjegjesine e tij permbushjen e ketyre te fundit, ka nenshkruar nje sere deklarata, ku deklarone se permbush te gjitha kriteret e kerkuara nga AK.

Sa me siper, autoriteti kontraktor, duhet te udhehiqet nga parimi i mireperdorimit te fondeve publike dhe perfitimi i nje produkti me cilesi te mire dhe me cmim me te ulet, si edhe nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, aq me teper ne kushte kur kemi nje percaktim te qarte te kriterëve dhe dokumentacionit qe duhet te paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet me se miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.

Gjithashtu, ne baze te nenit 62 "Detyrimet gjate zbatimit te kontrates" te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacern, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. R rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te rnonitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e rnallit/sherbimit do te jete e nejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.

5. Lidhur me arsyen per skualifikim;

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontratave; ne lidhje me kapacitetin teknik "Ekskavator me goma" sepse ky mjet i marre me qera nga subjekti Cobial shpk, rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq - Delvine, ne kundërshtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit. Ne lidhje me kapacitetin teknik "Ekskavator me goma" dhe me qera nga subjekti Cobial shpk, ky rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq - Delvine, ne kundërshtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte:

16. Ekskavator me goma Cope 1

Per permbushjen e ketij kriteri B.O.E ka paraqitur ne kete procedure:

1- Eskavator me goma LIEBHERR, A924 me kontrate qera noteriale, e vlefshme per te gjithë periudhen e ekzekutimit te kontrates, shoqeruar me te gjithë dokumentacionin teknik te nevojshem e te kerkuar.

2- Eskavator me goma AEMT 71 me kontrate qera noteriale, e vlefshme per te gjithë periudhen e ekzekutimit te kontrates, shoqeruar me te gjithë dokumentacionin teknik te nevojshem e te kerkuar.

Sa me siper, kontrata e mesiperme kane fuqine e ligjit per palet dhe se dyti pretendohet se keto mjete jane te angazhuara nga subjekti qiradhenes ne nje procedure tjeter prokurimi per te cilen OE ankimes nuk ka dijeni.

Ne kontraten e qerase jane parashikuar qarte, afati kohor, cmimi, dhe perfundimi i saj, Gjithashtu ne momentin e lidhjes se kontrates nuk eshte shfaqur apo pasqyruar ndonje pretendim i tille si dhe eshte garantuar se qiradhenesi ka te drejta te plota per nenshkrimin e kesaj kontrate.

Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kriterëve te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor.

Ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit..."

6.Lidhur me arsyen per skualifikim;

Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi, rezulton qe nuk ka paraqitur:

Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019. Nga ky operator nuk eshte paraqitur nuk eshte paraqitur vertetim per permbushjen e detyrimeve vendore per vitin 2019 ne Bashkine Vlore dhe Selenice ne te cilat ka pasur aktivitet si pjese e mirembjates se rrugeve, ne keto njesi administrative.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.2.3 eshte kerkuar "Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Operatori ekonomik B93 II shpk, pjese e ketij bashkimi, ne permbushje te kriterit te mesiperm ka paraqitur ne kete procedure:

1. Deklarate se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2019

2. Vertetim nga Bashkia Fier se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2019

3. Vertetim nga Bashkia Selenice se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2019

Operatori ekonomik B93 II shpk, nuk ka ushtruar aktivitet ne Bashkine Vlore pergjate vitit 2019.

7. Lidhur me arsyen per skualifikim;

Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterave te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit. • certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; Leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ne lidhje me kapacitetin teknik "Mjet transporti veteshkarkues mbi 8 tone" per mjetet me targa AA674LM, nuk eshte paraqitur certifikata e kontrollit teknik, ne kundërshtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Arsyeja e ngritur nga Komisioni i Vleresimit te ofertave, se per mjetin me targa AA674LM, nuk eshte paraqitur certifikata e kontrollit teknik, nuk qendron.

Nese do te kontrollohen me vemendje e pergjegjshmeri, dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, do te vihej re se Mjeti me AA674LM eshte paraqitur i shoqeruar nga kontrata e shitblerje fq 1 dhe 2, certifikata e pronesise fq 3 dhe 4, leja e qarkullimit fq 5 dhe 6, certifikata e kontrollit teknik fq 7, siguracioni fq 8, mandati i taksave fq 9, certifikata e transportit fq 10 dhe foto fq 11.

Sa me siper, Arsyeja e skualifikimit nuk qendron.

8. Lidhur me arsyen e skualifikimit;

Mjeti Batipal i blere me fature tatimore nuk ka paraqitur dokumentacionin qe vertetojne pronesine e mjetit. Autoriteti kontraktor duhet te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kriterave te percaktuara ne dokumentat e tenderit, duke perjashtuar ketu vleresimin mbi dokumenta shtese te pakerkuara nga autoriteti kontraktor.

Ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ...".

Ne DST nga ana e autoritetit kontraktor eshte specifikuar qartesisht se ne kushtet e mjeteve apo pajisjeve qe nuk shenohen ne rregjistra publik te paraqitet fatura tatimore e blerjes ose e zhdoganimit etj. Pra vet Ak ne kriteret e DST nuk ka percaktuar se sc bashku me faturen tatimore te shitjes duhet te paraqitet dhe dokumentacioni shoqerues qe provon pronesine e shitesit mbi pajisjen perkatese.

9. Lidhur me arsyen e skualifikimit;

Per mjetin Autobot uji eshte sipas fotos dhe dokumentacionit shoqerues te paraqitur eshte kamion me targa AA012YB, pra mjeti nuk eshte ne funksion te sherbimit te kerkuar sipas DST- BOE B 93 shpk & B93 II shpk nuk plotesojne kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, si me poshte vijon:

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2. 3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per

mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte:

7. Autobot uji ne pronesi ose me qira Cope 1

Per permbushjen e ketij kriteri B.O.E ka paraqitur ne kete procedure:

Autobot uji AA012 YB, me kontrate qera noteriale, e vlefshme per te gjithë periudhen e ekzekutimit te kontrates shoqeruar me certifikate pronesie, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni, mandati i taksave, certifikata e transportit dhe foto.

Nese Komisioni i Vleresimit te Ofertave, do te tregohej perseri i vemendshem do te vinte re se ne certifikaten e pronesise se mjetit dhe ne lejen e qarkullimit te tij, ne kategorine lloji i Mjetit eshte e percaktuar ATV. Dokumentacioni teknik duhet te shqyrtohen me pergjegjshmeri dhe objektivitet, duke lexuar te gjitha te dhenat e disponueshme ne to, asesi nuk mund te behet duke pare vetem fotografine.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, ka si objekt te punes se tij vleresimin e dokumentacionit teknik te paraqitur nga operatoret ekonomik pjesemarres, duke u bazuar ekskluzivisht dhe ne menyre objektive ne ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" ne Dokumentat standarte te tenderit te miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ne dokumentat Standarte per kete procedure eshte percaktuar qartesisht ne piken 2.3 Kapaciteti teknik, se kandidati/ ofertuesi per tu kualifikuar duhet qe te kete realizuar sherbime te ngjashme me objektin qe prokurohet me vlere jo me te vogel se 30 % e fondit limit te lotit perkates, realizuar me sukses gjate tri viteve te fundit.

Nga te dhenat qe te ofrohen nga Buletini i Njoftimeve Publike te cilat jane lehtesisht te verifikueshme, rezulton se operatoret ekonomik te kualifikuar nuk kane ekzekutuar asnje kontrate sherbimi mirembajtje, duke rene ndesh me vete kriteret e vendosura per kualifikim nga Autoriteti Kontraktor.

Si perfundim OE ankimes, nepermjet kesaj ankesen kerkon:

Kualifikimin e ofertes se paraqitur prej tij ne kete procedure prokurimi

Ose

Anullimin e procedures se prokurimit ne kushtet kur kriteret e vecanta te kualifikimit jane evasive dhe vleresimi i bere nga autoriteti kontraktor nuk eshte ne raport te drejte me vleresimet e OE te kualifikuar. AK ka detyrimin per vleresimin objekt dhe jo preferencial ne shqyrtimin e tyre duke favorizuar apo renduar pozitat e nje subjekti te caktuar.

Ne nenin 46, pika 1, germa "c" te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese":

Kriteret e kualifikimit duhet te jene te qarta, te sakta dhe te mirepercaktuara nga autoriteti kontraktor me qellim qe te jene sa me te kuptueshme jo vetern per operatoret ekonomike te interesuar per te gene pjesernarres, komisionin e vleresimit te ofertave ne rnenyre te tille qe procesi

i vleresimit te mos kryhet me subjektivizem, por te vendose ne suate te barabarte edhe per personat me aftesi te kufizuar, duke mos penguar keshtu pjesemarrjen ne nje procedure prokurimi.

Ne piken 3 te nenit 27 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, eshte percaktuar: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike ne perputhje me nenin 46 te LP P. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktues duhet te percaktojte dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve".

Sa me siper, ne kushtet kur konstatohet se nje pjese e kriterëve per kualifikim jane hartuar ne kundërshtim me percaktimet ligjore ne fuqi, te tilla qe krijojne konfuzion si tek operatoret ekonomike ashtu edhe tek autoriteti kontraktor gjate vleresimit te ofertave, situata e tille perben shkak dhe per anulimin e procedures se prokurimit.

Bazuar ne nenin 64, pika 3 te LPP - se, gjykojme se situata konfuze e krijuar nga mospercaktimi i qarte i kriterëve per kualifikim, perben shkak per anulimin e kesaj procedure prokurimi.

Ne nenin 31, pika 2 germa "d" te Vendimit te Komisionit te Komisionit te Prokurimit Publik nr. 596/2018, date 12.09.2018 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit te Prokurimit Publik", parashikohet se: "[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ te ankeses vehdos me akt te motivuar: d) Te anuloje procedurat per shpalljen e kontrates fituese dhe te udhezoi autoritetin kontraktor per rifillimin e procedures se prokurimit [...]".

Ne kushtet kur autoriteti kontraktor ka vleresuar mbi kriteret te paqarta, evazive dhe te hartuara jo ne perputhje me nenin 28 te VKM 914/2014, mbi te cilat ka bere edhe vleresimin e operatorëve ekonomike, procedura e prokurimit duhet te anulohet per shkaqet e sipercituara. (Shiko vendimin e KPP-se Nr. 176/2020).

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 7054/1 prot., datë 29.09.2020, protokolluar me tonën në datën 01.10.2020, me objekt “Informacion mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt Loti VII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Vlore (k/spital) - Peshkepi + rruga Peshkepi - Selenicë + rruga Peshkepi - Vllahinë + rruga Vllahinë - Poçem - Povel + rruga Levan - Vlorë (e vjetra) (76,7 km)”, me fond limit 169.211.472 (pa TVSH), Loti VII: REF:-65452-07-14-2020”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se arsyet e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:-

çertifikaten e pronësise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.; ne lidhje me kapacitetin teknik “Kamionçinë deri në 3.5tonë” per mjetet me targa BR 0898 B dhe AA 254 HI, jane perkatesiht BR 0898 B deri ne 6.6 ton dhe AA 254 HI deri ne 5.6 ton, pra mbi 3.5 ton, ne kundërshtim me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik B 93 shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronësine e mjetit:- çertifikaten e pronësise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.; ne lidhje me kapacitetin teknik “Ekskavator me goma” sepse ky mjet i mare me qera nga subjekti Cobial shpk, rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq – Delvine, ne kundërshtim me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit.

Ne lidhje me kapacitetin teknik “Ekskavator me goma” dhe me qera nga subjekti Cobial shpk, ky rezulton te jete i angazhuar ne kontrata qe ka subjekti ne Kardhiq – Delvine, ne kundërshtim me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik B 93 II shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ka permbushur piken 2.3.10 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronësine e mjetit:- çertifikaten e pronësise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ne lidhje me kapacitetin teknik “Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 tonë” per mjetet me targa AA674LM, nuk është paraqitur certifikata e kontrollit teknik, ne kundërshtim me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit.Mjeti Batipal I blere me fature tatimore nuk ka paraqitur dokumentacionin që vertetojne pronësine e mjetit. Për mjetin Autobot uji është sipas fotos dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur është kamion me targa TRAA012YB, pra mjeti nuk është në funksion të shërbimit të kërkuar sipas DST.” nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10, për Lotin VII “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.10, të dokumentave të tenderit përcaktohet:

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte.

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 tonë	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1

3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Frezë asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët	në pronësi ose me qira	Copë 8
11	Kamionçinë deri në 3.5tonë	në pronësi ose me qira	Copë 3
12	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Fadromë	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Ekskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Makineri për vijëzim rrugor	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails)	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore	pronësi /qira/ kontrate furnizim	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku të jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratave.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratave.
- Për fabrikën e asfaltobetonit, nëse është në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nëse është marre me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratave.
- Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltobetonit mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatore ekonomike. Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që verteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës / kontratave.

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të beje deklarin e adreses se sakte të vendodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre*”
Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarinimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pikë 3, germa ”a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.

2.3.11 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këto të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarinimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pikë 3, germa ”a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.

****Dokumentet e siguruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara me vulë apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”. (Konventa e Hagës 5 TETOR 1961)**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

III.1.2. Në shtojcën 10, “Kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit”, të dokumentave të tenderit përcaktohet:

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. *Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*

b. *Prokura e posaçme.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “B93II” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k” sh.p.k. të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur si më poshtë vijon:

-Dokumenti “Kontratë bashkëpunimi për bashkimin e përkohshëm të shoqërive”, Nr.2602 Rep., Nr.820/1 Kol., datë 04.08.2020

Në këtë kontratë bashkëpunimi në nenin 3 të saj “Ndarja e punimeve”, është përcaktuar se:

“Llojet e punimeve që duhet të kryejë secila palë për Sipërmarrjen e Përbashkët përcaktohet Aneksin Nr.1, të bashkëlidhur kësaj kontrate bashkëpunimi.

- “B93II” sh.p.k.	do të kryejë	47%
- “B-93” sh.p.k.	do të kryejë	53%

Pagesat, fitimet dhe humbjet duhet të përkohet me punimet e kryera nga secila palë.

Secila palë duhet të paguhet për punimet e kryera sipas ndarjes së punimeve në kontratë por autorizimin për paraqitjen e faturave tatimore dhe situacioneve përkatëse në Autoritetin Kontraktor e ka vetëm shoqëria “B93 II” sh.p.k. [...]”

Bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit është edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, ku deklarohet se përfaqësuesi i këtij bashkëpunimi të shoqërive do të jetë shoqëria “B93 II” sh.p.k.

III.1.4. Në nenin 46, pikë 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti

kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.5. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.* Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.6. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.7. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përkshuar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.*

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, K.P.P. konstaton se, në marrëveshjen e bashkëpunimit të palëve, në nenin 3 të saj, është parashikuar “Ndarja e punimeve”, ku konkretisht citohet *“Llojet e punimeve që duhet të kryejë secila palë për Sipërmarrjen e Përbashkët përcaktohet Aneksin Nr.1, të bashkëlidhur kesaj kontrate bashkëpunimi. “B93II” sh.p.k. do të*

kryejë 47%; “B-93” sh.p.k. do të kryejë 53%”, por edhe pse bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në marrëveshjen e bashkëpunimit të tyre ka cituar se llojet e punimeve që do të kryejë secila palë gjenden në Aneksin 1, bashkëlidhur kësaj kontrate, KPP konstaton se “Aneksi 1”, nuk gjendet në asnjë prej dokumentave të dorëzuar në SPE nga ky bashkim i operatorëve ekonomikë ankimues. Pra, sa më sipër, për sa kohë dokumenti “Aneksi 1” nuk gjendet bashkëlidhur kontratës së bashkëpunimit që palët kanë paraqitur, KPP gjykon se në marrëveshjen e bashkëpunimit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk janë parashikuar në mënyrë të detajuar elementët konkretë të punimeve që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

Referuar nenit 74 pika 1 të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar parashikohet se në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se marrëveshja e bashkëpunimit e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk përmbush një prej kushteve kryesore të parashikuar nga VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. Komisioni sqaron se ndarja e zërave konkretë është një kërkesë e parashikuar në aktin normativ si më sipërcituar dhe është një faktor i rëndësishëm mbi të cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e përmbushjes së secilit kriter të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithnjë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Në rastin konkret është përcaktuar vetëm përqindja e pjesmarrjes në bashkëpunim për secilin nga anëtarët e bashkimit, por në marrëveshjen e bashkëpunimit nuk rezulton ndarja e zërvave dhe elementëve konkretë të punimeve që do të realizojë secili prej tyre. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për vërtetimin e krijimit të bashkimit dhe konkretisht kontrata e bashkëpunimit në të cilën nuk është bërë ndarja konkrete e zërave të punimeve objekt prokurimi, nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, duke bërë të pamundur verifikimin e plotësimit të dokumentacionit të paraqitur nga secili anëtar i këtij bashkimi në përputhje me përqindjen e marrë përsipër.

III.1.8. KPP vlen të theksojë se, forma e pjesmarrjes në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi është e përcaktuar shprehimisht në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të saj dhe nuk lë vend për konfuzion. Në këtë kuptim KPP gjykon se BOE ankimues ka pasur detyrimin ligjor të paraqesë kontratën e bashkëpunimit, preventivin në përputhje me përcaktimet ligjore duke përcaktuar në të pjesën e punës që do të realizojë secili prej tyre në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratë, dhe që më pas referuar këtyre elementëve dhe zërave konkretë të marrë përsipër nga secili, të bëhej shqyrtimi dhe vlerësimi i kapaciteteve ekonomiko financiare dhe teknike.

III.1.9. Akoma më tej, vetë palët, në kontratën e bashkëpunimit kanë cituar se, “*Llojet e punimeve që duhet të kryejë secila palë për Sipërmarrjen e Përbashkët përcaktohet Aneksin Nr.1, të bashkëlidhur kësaj kontrate bashkëpunimi.*”, por ky Aneks nuk gjendet në asnjë prej dokumentave të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në Sistemin e Prokurimit Elektronik. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me LPP. Pra, operatori ekonomik ankimues ka barrën e provës të vërtetoje se i përmbush të gjitha kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor.

III.1.11. Sa më sipër argumentuar, për sa kohë me dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, nuk vërtetohet se cilat zëra/element konkretë ka marrë përsipër secila nga palët pjesëmarrëse në bashkim, rrjedhimisht është i pamundur vlerësimi nëse ky bashkim plotëson kriteret në lidhje me mjetet (arsye skualifikimi e ankimuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë), pasi ky kriter duhet të konsiderohet i plotësuar nga secila palë, në përputhje me përqindjen dhe zërat e punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Akoma më tej, Komisioni sqaron se, në rastin konkret objekti i prokurimit përfshin punë publike, ndarja e zërave të këtyre punimeve është tepër e rëndësishme, pasi ndarja e tyre për secilin anëtar të bashkimit të përkohshëm të shoqërive është një faktor i rëndësishëm mbi të cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e përmbushjes së secilit kriter të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithnjë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do mbetet i skualifikuar në procedurën e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “B93II” sh.p.k. & “B-93” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-65452-07-14-2020, me objekt: Loti VII “*Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Vlore (k/spital) - Peshkepi + rruga Peshkepi - Selenicë + rruga Peshkepi - Vllahinë + rruga Vllahinë - Poçem - Povel + rruga Levan - Vlorë (e vjetra) (76,7 km)*”, me fond limit 169.211.472 (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1135 Protokolli

Datë 18.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri